

## Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", organizon takim të hapur me Ministren e Arsimit dhe Sportit, Znj. Ogerta Manastirliu

Në një nismë për të përforcuar bashkëpunimin mes institucioneve të arsimit dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Ministrja Ogerta Manastirliu ka nënshkruar me Bashkinë Elbasan Marrëveshjen për Kartën e Studentit . Kjo kartë do të ofrojë tarifa të reduktuara për transport, shërbime social-kulturore dhe oferta nga bizneset. Në këtë veprimtari përshëndeti Rektori i Universitetit të Elbasanit Prof.Dr. Skender Topi dhe përfaqësuesi i Këshillit Studentor.

Në vizitën e saj në Qytetin e Elbasanit, Ministrja Manastirliu u ndal në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", ku zhvilloi një takim të hapur me personelin akademik dhe studentët e universitetit, ku u diskutua për përmirësimin e cilësisë në veprimtarinë akademike, kërkimit shkencor dhe inovacionit, si dhe fuqizimin e infrastrukturës dhe resurseve nëpër institucionet e arsimit të lartë.



